

VENDIM
Nr.382, datë 18.5.1998

PËR DISA NDRYSHIME NË KOMISIONET E PËRHERSHME TË KUVENDIT POPULLOR

Në mbështetje të neneve 25 dhe 28 të kreut të katërt të Rregullores së Kuvendit Popullor, me propozimin e Kryesisë së Kuvendit Popullor,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në komisionet e përhershme bëhen këto ndryshime:

1. Komisioni për Mjetet e Informimit Publik dhe Komisioni për Arsimin, Kulturën, Shkencën e Sportin nga 9 anëtarë bëhet me 11 anëtarë.
2. Në Komisionin për Politikën e Jashtme, në vend të zotit Ilir Meta caktohet zoti Maqo Lakrori dhe në vend të zotit Agim Fagu caktohet zoti Petro Koçi.
3. Në Komisionin e Mjeteve të Informimit Publik do të bëjë pjesë edhe deputeti Ardian Myslymi nga grupi parlamentar i Partisë Socialiste.
4. Në Komisionin për Arsimin, Kulturën, Shkencën dhe Sportin bën pjesë edhe deputeti Ilo Kostandini i grupit parlamentar të Partisë Socialiste.
5. Në Komisionin e Ligjeve në vend të deputetit Fehmi Abdiu caktohet deputeti Mark Nikolla.
6. Në Komisionin e Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit në vend të zotit Shkëlqim Cani caktohet deputeti Lekë Çukaj, në vend të zotit Anastas Angjeli caktohet deputeti Flamur Rogu dhe në vend të zotit Ilir Meta caktohet deputeti Ejup Tabaku të grupit parlamentar të Partisë Socialiste.
7. Në Komisionin e Punës dhe Problemeve Sociale në vend të zotit Sherif Bundo caktohet deputeti Elmaz Sherifi, ndërsa deputetja Merita Ndreko plotëson vendin vakant në këtë komision.
8. Në Komisionin për Industrinë dhe Punët Publike caktohet deputeti Maksut Balla i grupit parlamentar të Partisë Socialiste në vendin bosh të lënë të pa plotësuar nga grupi parlamentar i Partisë Demokratike.
9. Në Komisionin e Bujqësisë dhe të Ushqimit në vend të ish-deputetit Gafur Mazreku caktohet deputeti Lush Përpali.
10. Në Komisionin e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit në vend të deputetit Bilal Draçi caktohet deputeti Zabit Brokaj.
11. Komisioni i Imunitetit, Mandateve dhe Rregullores nga 7 anëtarë bëhet me 11 anëtarë. Në këtë komision do të bëjnë pjesë edhe deputetët Lili Nushi, Ndre Legisi dhe Dalip Pero të grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Nard Ndoka dhe Zef Bushati të grupit parlamentar “E Djathta e Qendrës”, Fatbardh Hushi nga “E Djathta e Bashkuar Shqiptare” dhe Vladimir Fejzo i grupit të “Qendrës Liberale”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.